



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-31523-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.29.09.2025, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi, (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala, (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Albana Shillova Shalaku (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Biljana Spasic dhe Ratomir Ristic (SL)

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi Planifikimit të Buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i caktimit të normave tatimore për vitin 2026
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Deklaratës mbështetëse kundër dhunës ndaj grave në politikë
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuar 2026-2029 dhe Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës me nr. të protokolit 05-070-05-24497-25, e dt.15.09.2025
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 19 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 20 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e planifikimit të buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028.

Enver Gashi – Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e hapëm temën e buxhetit dhe ne si grup jemi dakord që ky buxhet të votohet sot ashtu si është, pasi që i ka krye të gjitha procedurat ligjore.

Sami Ahmeti – Për mos me zgjatë shumë për mendimin tonë si grup ky buxhet nuk përfaqëson ndonjë zhvillim ekonomik, nuk ka mbështetje për mirëqenie për bujqit, për ambientin, për shëndetësinë, për zyrtarët administrativ që i kemi dhe si rrjedhojë ne do të votojmë kundër tij.

Ajet Berisha – Më shumë se sa vlerësim, unë i kam disa pyetje që shpresoj se do të marrë përgjegje që kryesisht kanë të bëjnë me kogjenerimin. Unë e di që është projekt i rëndësishëm për qytetarët, por në bazë të kontratave të derisotme që Komuna i ka bërë, në bazë të planifikimeve nga buxheti ynë që janë për 3 vite dhe në bazë të kërkesave për donacion seriozisht shumë po kam dyshime për këtë projekt sa ka me na kushtue për Obiliq, sa do të kushtoj me shkue deri në Milloshevi dhe Mazgit. Unë nga krejtë kjo e kam krijuar përshtypjen në bazë të një planifikimi se shkon mbi 70 milionë pa e ditë a shkon edhe deri në Milloshevi dhe Mazgit. Në bazë të këtyre kërkesave që janë bërë dhe kontratave, me 70 milionë e bëra njëfarë matematike për 40 vjet, 4,000 familjeve të Komunës së Obiliqit me ia dhënë nga 500 euro. Këtë, po e ngriti sepse vërtetë nuk kemi njohuri sa ka me kushtue, deri ku ka me shkue, çka është planifikue dhe është shumë amulli e madhe në këtë drejtim. Unë kisha pasë dëshirë me ditë sa ka me na kushtue ky projekt për Obiliq, sa deri në Milloshevi, sa deri në Mazgit dhe a ia vlen barra qiranë gjithë këto mjete me i marrë e me mbetë projektet tjera në zero, ose me qenë shumë pak të dukshme që me shkue gjithë këto mjete në këtë investim. Duke mos pasë absolut informata qysh është gjendja për këtë po e shtroj në këtë mënyrë, që me kuptue më qartë sa ka me kushtue sepse edhe këto janë para të qytetarëve, sa ka me i kushtue qytetarëve të Obiliqit kogjenerimi.

Kryetari – Tash, shifrën e saktë nuk e kam është afërsisht 50 milionë, është mendue që do të ketë mbështetje apo edhe me kredi të buta e donacione, por për shkak të sanksioneve që aktual është shteti ynë unë nuk kam arritë me bankat. Ne kemi provue me Berzhin me bankën botërore nuk kemi arritë me marrë ndonjë përgjegje pozitive. Gjithashtu, e dini se kemi adresue edhe amandamente në Parlament, në grupe parlamentare por nuk kemi hasë në mirëkuptim. Tani, është nënshkruar faza e dytë e shtrirjes së gypave e cila do të përmbyllë pjesën e mbetur në Obiliq dhe do të vazhdoj në drejtim të Mazgitit dhe Milloshevës. Po ashtu, e kemi një marrëveshje me Prishtinën, e cila nga stacioni i shpërndarjes deri te Kosova B bashkë me nënstacionin e veçantë për Komunën tonë që është vlera dikund rreth 8 milionë, është pjesë e investimit të Prishtinës. Në javën e kaluar e patëm një mbledhje me Kryetarin e Prishtinës dhe me grupet punuese, kështu që mbetemi me shpresë se ata shumë shpejtë do të fillojnë me pjesën e projektit. Ne do të vazhdojmë me projektin, është shumë domethënëse për qytetarët e Obiliqit, edhe në kuptimin e impaktit të ambientit edhe në kuptimin e kursimit të energjisë. Nëse, do të ketë lëvizje apo mundësi nga ndonjë bankë ne do të jemi të gatshëm që me zbutë koston e investimit përmes kredive dhe besoj se me përmbylljen e këtij projekti qytetarët e Obiliqit do të përfitojnë shumë.

Ajet Berisha – Në bazë të planifikimeve dhe dokumenteve deri tash dikund 20 milionë keni bërë kontrata me mbikqyrje me 2 kontratat e nënshkruara, 43 milionë i kërkon donacion dhe 11 milionë janë planifikime, e këto bëjnë mbi 70 milionë. Ju po thoni se kushton mbi 50 milionë, unë këtë problem e kam do të thotë në bazë të planifikimeve, kërkesave dhe kontratave projekti shkon mbi 70 milionë, apo nuk është në ndonjë harmoni me këtë dokument që e tejkalon mbi 20 milionë, atë që po thoni ju se kushton mbi 50 milionë. Në këtë drejtim po e kam problem me kuptue sa ka me na kushtue, që për mua edhe 50 milionë është projekt që është dashtë me mendue, por është pajtue Kuvendi që ky projekt me ecë. Mendoj se 70 milionë nuk ia vlenë barra qiranë për këtë projekt sepse është shumë i kushtueshëm për vlerën, plus ka me pague qytetari i Obiliqit prapë hiç përveç mjedisit pjesa tjetër është projekt shumë i kushtueshëm që nuk ka as benefit. Do të thotë kur bëhet krejtë ky planifikim nuk ia ka vlerë me nisë dhe me shkue mjetet e buxhetit të Komunës.

Kryetari – Planifikimi i projektit është duke u zgjerue dhe nuk do të jetë vetëm Millosheva e Mazgiti, por do të shtrihet në krejtë pjesën e Komunës tonë duke përfshi Llazarevën, Bakshinë, Raskovën edhe Plemetin deri në përmbyllje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për 3 vota kundër dhe 5 vota abstenim morën Vendim për Aprovimin e Planifikimit të buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e caktimit të normave tatimore për vitin 2026.

Enver Gashi – Kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtue edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, që është për çdo vit ligjore dhe ne jemi për atë që të kalojë edhe në Kuvend.

Sami Ahmeti – Ashtu siç e thamë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, duke pasqer parasysh se këto norma nuk kanë ndonjë ndryshim nga normat e vitit që tash po shkon, ne jemi pro këtij vendimi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim për Aprovimin e caktimit të normave tatimore për vitin 2026.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e Deklaratës mbështetëse kundër dhunës ndaj grave në politikë.

Enver Gashi – Ne si grup jemi për që të aprovohet kjo Deklaratë mbështetëse kundër dhunës ndaj grave në politikë.

Sami Ahmeti – Ashtu, siç e thamë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ne jemi që ti mbështesim secilën kategori të shoqërisë aq më tepër këtë kërkesë, kështu që ne jemi pro aprovimit të kësaj Deklarate.

Ajet Berisha – Sinqerisht kur e lexova e pata një përshtypje se ka ndodhë diçka, krejtësisht e pakuptimtë po më duket. Mendoj se ka kaluar ajo fazë kur është dashtë me mbështetë, bile për Komunën e Obiliqit në daç për buxhetim, në daç me numrin e të punësuarve, në daç me krejtë na kenë dalë përmbi. Ndoshta, ne duhet me bë një grup të burrave që me ua ndryshue pak këtë gjendje se gati në absurd po shkon sepse nuk është ajo gjendja as mentale, as qëllimore, as kurgjë. Ju votone ndërsa, unë nuk marrë pjesë në këtë votim hiç, por ka kalue faza kur dikush dikend mundet me detyrue me bë, me ngacmue sepse kemi institucione të lajmëron, ta humbë karrierën, kështu që jemi bërë të vëmendshën dhe situata ka ecë pak përtej kësaj hajde të barazohemi, hajde të ia mundim. Mendoj se është e pakuptimtë, është mendim krejtë personal kështu që vendosni si të doni, por duhet me u brengos burrat.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota për morën vendim për Aprovimin e Deklaratës mbështetëse kundër dhunës ndaj grave në politikë.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuar 2026-2029 dhe Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Enver Gashi – Ne si grup jemi për që kjo pikë e rendit të ditës të votohet, pasi që veç i ka kalue të gjitha fazat e shqyrtimit.

Sami Ahmeti – Duke qenë se këtë plan nuk kemi pasë kohë ta shqyrtojmë, nuk mund të votoj as pro as kundër sepse në cilëndo anë që të votojmë do ti hynim në hak dikujt, prandaj ne do të abstenojmë.

Ajet Berisha – Unë jam përpjekë me u përgatitë, nuk po them as plan i mirë as i keq, ka obligime që marrim si Komunë dhe shpresoj që të formohet ndonjë Komision që ka me i mbikqyrë që këto të realizohen. Nevojiten shumë trajnime, por edhe mjete shtesë që me u marrë me këtë kategori secili sektor i Komunës. Unë do të votoj për me shpresë që një Komision i caktuar ka me përcjellë zbatimin e kësaj Strategjie, që me iu dalë në ndihmë kësaj kategorie.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 17 vota për dhe 3 vota abstenim morën Vendim për Aprovimin e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuar 2026-2029 dhe Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Kryetari – Meqë, sipas agjendës e kam një takim tani, dua të ju falenderoj për një bashkëpunim të mirëfilltë në këtë mandatë dhe shpeshherë kemi pasë mendime të kundërta, por besoj se secili e ka pasë për qëllimin më të mirë. Ju uroj shëndet së pari në familjet tuaja dhe të gjithë ju që jeni në garë suksese

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës me nr.të protokolit 05-070-05-24497-25, të dt.15.09.2025.

Enver Gashi – Ne si grup jemi për që kjo kërkesë të aprovohet në Kuvend.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 6 vota abstenim morën Vendim për Aprovimin zgjerimin e Listës rezervë me emrin e dëshmorit “Hasan Krasniqi” i cili emër do të shërbej për emërtimin e rrugës, e cila deri më tani nuk ka pasë emërtim zyrtar që gjendet në Obiliq, Komuna e Obiliqit.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Ministria e shëndetësisë për shfuqizim të vendimit për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore për stafin e policisë në Komunën e Obiliqit.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 17 vota për morën Vendim për Shfuqizimin e vendimit nr.01-060-01-21427-25, të dt.01.08.2025 për lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore për stafin e policisë në Komunën e Obiliqit.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Sindikata e Administratës të Komunës së Obiliqit, për realizimin e shujtave ditore për nëpunësit e shërbimit civil të administratës të Komunës së Obiliqit.

Enver Gashi – Ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e kemi trajtue këtë pikë dhe si grup e kemi dhënë vizën që të vjen në Kuvend, të aprovohet me arsyetimin se dihet shërbyesit civil i kanë pagat e ulta, sado pak bile një shujtë me ua heqë.

Sami Ahmeti – Ashtu siç e thamë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, në parim ne jemi pro marrjes së kësaj shtese, apo shujtë. Unë kisha pasë dëshirë nëse, veç zonja që e ka bërë kërkesën është këtu, me bërë një pyetje pse pagat e ulëta, çka nënkupton me pagat e ulëta sepse me miratimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës, ne kemi vërejtë se pothuajse shumica e shërbyesve civil në Komunën e Obiliqit janë të pakualifikuar. Kjo, do të thotë kanë hy në formë të ndryshme në punë për çka ne nuk po dojmë me prekë atë pjesë dhe për këtë arsye janë pagat e ulëta, nën 1. Në 2 kisha pasë dëshirë shumë mirë po flitet për një shumë 169,000 euro, a është dikush prej zyrës së financave me na tregue nga cila linjë buxhetore do të merren këto mjete që të paguhet. E treta praktikë ekzistuese që e ka cekë kërkesja, te praktikë ekzistuese thuhet se në disa Komuna veç implementohet kjo shujtë në ndërkohë unë jam mundue shumë me pyet dhe deri tash nuk e kam gjetë asnjë Komunë që e ka këtë shujtë. Këto, pyetje nuk po i bëjë për me pengue, ne jemi pro qysh në fillim e thashë, por po i bëjë që të mos jetë një kamuflim se sikur gjërat tjera, çka po i bëjmë se pak më heret e shfuqizuam vendimin për stafin policor, kështu që vetëm le të jenë të arsyetuara dhe të menduara mirë ne jemi pro gjithmonë.

Ajet Berisha – Kjo kërkesë ka ardhë edhe më heret në këtë Kuvend dhe duke mos qenë krejtë të barabartë për stafin që punojnë dhe janë kompetencë e Komunës, unë edhe atëherë edhe sot jam kundër. E para, unë mendoj se ligjërisht nuk jemi në rregull dhe kjo kërkesë do të kthehet ashtu siç e tha parafolësi, ashtu qysh u kthye ajo për stafin policor sepse është Ligji i pagave që i përcakton të drejtat, obligimet dhe benefitet për secilën kategori, që në shujtë nuk ka paraparë. Shujtën në këtë drejtim e ka pasë shëndetësia, ajo është heqë me Ligjin e pagave, pse ka të drejtë Komuna në këtë drejtim për një pjesë të punëtorëve me nxjerrë këtë shujtë, e për disa që e kanë pasë edhe më heret mos me pasë. Pse kjo, nuk vlen për shëndetësinë, pse kjo nuk vlen për arsimin, pse kjo nuk vlen për të gjithë punëtorët që janë në kompetencë të buxhetit për të cilin planifikon Komuna. Duke qenë parçiale dhe unë duke qenë punëtor shëndetësor, as nuk kam të drejtë me përkrahë, por duke qenë edhe kundërligjore që mendoj se është kundërligjore, unë jam kundër.

Ganimete Aliu – Ne nuk jemi të parët që dojmë me aprovue këtë kërkesë sepse Komuna e Prishtinës është veç duke e gëzuar këtë të drejtë nga mallrat dhe shërbimet dhe të hyrat e tjera, që varet prej Komunës. Gjithashtu, Komuna e Fushë Kosovës, e Klinës, e Istogut dhe e Pejës, që besoj se edhe ju keni pasë kontakte me kryesues të Kuvendeve. Ne kërkojmë mirëkuptimin tuaj dhe kjo kërkesë e jona të aprovohet.

Unë si Kryetare e sindikatës të shërbyesve civil nuk jam kompetente që ti mbroj punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë sepse punëtorët e shëndetësisë e kanë kryesinë e sindikatës të vetë. Po ashtu, edhe arsimit që tashmë po dihet se Komunitat janë paralizuar nga kontratat kolektive. Unë jam Nënkryetare e sindikatës në nivel qendror dhe ne kërkojmë të takohemi me Kryeministrin, e kemi të përgatitur dhe të rregulluar kontratën për shërbyesit civil, kështu që shpresojmë në të ardhmen të gjejmë mirëkuptim të takohemi, të sqarohemi dhe kjo kontratë e jona të aprovohet. Unë kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj dhe mbetem me shpresë që kërkesa jonë të aprovohet.

Ajet Berisha – Faleminderit për këshillat dhe informatat që na i ofrove. Në rast se sindikata e shëndetësisë nuk e ka bërë këtë kërkesë nëse, është puna veç për kërkesë, unë si anëtar i Kuvendit bëj kërkesë në emër të 105 punëtorëve të shëndetësisë, që shuma shkon dikund rreth 130,000 euro, në bazë të atij kalkulimi që e ka bërë zënjja. Unë kërkoj që ky Kuvend ta shqyrtoj edhe kërkesën time për 105 punëtorë të shëndetësisë që të përfshihen në shujtë prej 5 euro. Meqë po mungon vetëm kërkesa unë si anëtar kam të drejtë me bërë këtë kërkesë dhe besoj se kam me gjetë bashkëpunimin te stafi shëndetësor dhe nuk kanë me më kritikue.

Labinot Mirena – Unë pajtohem plotësisht me zënj.Ganimete Aliu, është më e pakta që mund të bëjmë ne për ata, bile unë kisha thënë mos me lënë 5 euro, por 7 euro, pasi që e kam numrin 7 unë i përkrahu.

Enver Gashi – Një sqarim z.Ajet, nuk po të shikoj por po mundohem me të vënë në rrugë se dihet shumë mirë qysh shkojnë procedurat për me ardhë një pikë e rendit të ditës në Kuvend. Së pari duhet të bëhet kërkesa me kohë sepse vetëm që nuk ka ardhë për 7 ditë një Kuvend na është anulue, duhet të kaloj në Komitetin për Politikë dhe Financa, ti jepet viza me ardhë këtu, pastaj aprovohet ajo kërkesë ose refuzohet.

Ajet Berisha – Nuk ka çështje që anëtarit të Kuvendit Komunal i pengohet për me ngritë dhe për me votue aty për aty, nuk ka çështje absolut. Në rast se kërkohet mendim i Drejtorisë së financave, jepet dhe unë edhe shumë po ua jap 121,000 euro, për 105 punëtorë në bazë të atij kalkulimi. E qartë është kjo si loti çka po kërkoj unë, do të thotë nuk mundet askush me ma mohue se unë e kam këtë të drejtë ma jepë Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, çkado qoftë që jam në harmoni me ligjin me kërkue, e jo me thënë e ka këtë procedurë. Unë kërkoj këtu, e Drejtoria mundet me dhënë përgjegje sikurse ka mendue për ato 140,000 euro, do të thotë këtë të drejtë shfij grupit të LDK-së, nuk mundet me ma mohue askush sepse ligji ma ka dhënë. Procedurën e ngriti unë dhe me atë duhet me u marrë Kuvendi.

Sami Ahmeti – Derisa u ngritën këtu, këto paralelizma që unë e konsideroj me të drejtë sepse ne nuk jemi vetëm këshilltarë komunal të shërbyesve civil, por jemi edhe të atyre që janë në shëndetësi, edhe të atyre që janë në arsim. Unë propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme, pastaj të inkorporohen të gjithë në mënyrë që mos të ketë parcializime. Në këtë rast ne si grup do të abstenojmë në rast se veç e vendosni si pikë të rendit të ditës.

Kryesuesja – Kjo kërkesë veç ka qenë në mbledhjet e mëhershme dhe e kemi shtye sepse në kërkesën e parë është kërkuar në mënyrë retroaktive pagesa e shujtës, që nuk ka qenë e mundshme. Tani, e kanë heqë pagesën e shujtës në mënyrë retroaktive dhe e kemi kërkesën tjetër për realizimin e shujtës nga tetori e tutje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 11 vota për 1 votë kundër dhe 7 vota abstenim morën Vendim për Aprovimin e kërkesës për realizimin e shujtave ditore për nëpunësit e shërbimit civil të administratës të Komunës së Obiliqit.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Pyeti se a jeni të pajtimit ta shqyrtojmë edhe kërkesën e anëtarit të Kuvendit për shujtë të punëtorëve të shëndetësisë.

Enver Gashi - Unë personalisht mendoj se po shkelen procedurat e punës të këtij Kuvendi . Në parim ne jemi për miratimin e shujtës edhe për punëtorët e shëndetësisë, por kërkesa duhet të vjen me shkrim të kaloj në Komitetin për Politikë e Financa, të vjen në Kuvend pastaj e votojmë.

Ajet Berisha – Ju mundeni me u deklarue se a jeni pro apo kundër kërkesës time dhe me arsyetue qysh doni, por me votue duhet për këtë punë sepse unë po bëj kërkesë. Drejtoria e financave le te arsyeton që

nuk ka mjete, e ju arsyetone qe nuk ka arane ne Komitet, por me votue dundet. Une si anetar i Kuvendit kam te drejte me be kerkesë dhe kërkoj e insistoj të hudhet në votim.

Kryesuesja – Po, keni të drejtë.

Labinot Mirena – Kryesuese, tash është kohë fushate dhe secili i shfrytëzon minutat e vet me të fushatë elektorale këtu. Unë pajtohem plotësisht se duhet me pasë shujtën edhe shëndetësia e arsimit nëse nuk kanë, por duhet me të bëjë kërkesën. Unë jam edhe për shëndetësi dhe arsim për të dyja bashkë prandaj, përfaqësuesit e tyre të sindikatave le të bëjnë kërkesën, le të vijnë të diskutojnë dhe ne jemi për aprovim.

Valbonë Beka – Edhe unë po ashtu, në emër të mësimdhënësve mendoj se kemi të drejtë për derisa të tjerët kërkojnë atëherë le të bëhet në nivel Komune për të gjithë punëtorët administrativ, e jo vetëm për disa të bëhet, e për disa jo.

Enver Gashi – U bë kjo temë kush çka po don, por nëse unë foli diçka në emër të një grupi, në emër të një institucioni për shëndetësi ose arsim duhet me u bazue në ndonjë takim, në ndonjë sindikatë sepse si të thuash në emër duhet me u bazue në diçka, ndërsa personale është diçka tjetër. Unë e kuptoj jemi në fushatë, por parimet janë parime, ka edhe antifushatë dhe ne jemi në mbledhjen e fundit ku në vend se të jetë më shumë solemne, ne po shkojmë nga ajo ta mujta, ma mujte.

Ajet Berisha – Sa për informatë nuk jam pjesë e garës elektorale z.Enver dhe z.Labinot, unë nuk kam të bëjë me asnjë listë, as nuk jam duke i kërkuar votë askujt nëse, nuk e keni ditë që ma merrë mendja se e keni ditë. Këtu, po përjashtohen 2 kategori që është përgjegjësi e kësaj Komune, e që është një lloj padrejtësie ndaj atyre 2 kategorive, e para. E dyta, në çdo kërkesë çfarëdo qoftë përveç kundërligjore, ju duhet me u deklarue në propozimin e anëtarit të Kuvendit, është rregullë e paraqes propozimin e ju jeni për ose kundër, arsyetone.

Arben Berisha – Deshta të kontriboj në këtë drejtim në emër të Ekzekutivit. Ne i kemi edhe 2 kërkesa tjera, që dolën nga ky takim dhe ne si Ekzekutiv nuk jemi kundër këtyre kërkesave, por meqë kanë një impakt buxhetor bukur të madh kishte me qenë mirë të mbetet për seancat e radhës, me harmonizue buxhetin e vijat buxhetore se nga do ti marrim mjetet. Nëse, aprovohet kjo nga ana juaj do të jetë problem ekzekutimi i mjeteve prandaj, Kuvendi me Ekzekutivin duhet të harmonizohet me vijat buxhetore se ku do të merren mjetet. Ne jemi shumë të papërgatitur në këtë seancë që me dhënë një verdikt të fundit, kur nuk e dijmë se nga do ti marrim mjetet financiare. Pra, kërkoj mirëkuptim nga ana juaj, le të mbetet për seancën e radhës sepse kushdo që të jetë në mandatin e ardhshëm nuk do të jemë kundër duke e ditë kontributin e tyre në vazhdimësi.

Kryesuesja – Ne diskutoam në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe u dakorduam që të konsultohemi me Komunitat që i kanë aprovue vendimet e tilla, në mënyrë që mos të kthehen si të kundërligjshme që jemi konsultue me Komunitat e Prishtinës dhe Komunitat tjera, të cilat e kanë gjetë bazën ligjore dhe kanë marrë vendime të tilla. Edhe unë mendoj se kishte me qenë mirë që kërkesa të vjen me shkrim, të gjendet baza ligjore sepse ligji nuk është i njëjtë si për shëndetësi, si për shërbyesit civil.

Atëherë, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal i kemi 2 propozime për shëndetësi dhe arsim, a jeni të pajtimt që të shtyhet shqyrtimi i tyre për seancën e radhës.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për, 1 votë kundër dhe 3 vota abstenim votuan që shqyrtimi i kërkesës së shëndetësisë dhe arsimit për shujtë të punëtorëve të tyre, të mbetet për seancën e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora 11:58'

Bashk. prof. për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi